



KOLEGJI DARDANIA

Rr. "Ibrahim Lutfiu" Nr. 93, 10000 Prishtinë

Tel: +383 (0) 38 247-587 / +383 (0) 38 247-588

Web: www.kolegjidardania.com



Në bazë të nenit 5 të Statutit të Kolegjit Dardania, Këshilli drejtues I Kolegjit Dardania – Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me datën 18.10.2021, miratoi:

RREGULLORE PËR BURSA DHE MBËSHTETJE FINANCIARE PËR STUDENTË

I – DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret, mundësitë, detyrat dhe përgjegjësitë e përfituesve të Bursave, lehtësimit të shkollimit të kategorive të studentëve si dhe përcaktohet procedura për aplikim për Nivelin Bachelor (BA) dhe Master (MA), si dhe parashihet procedura për aplikim dhe apelim të vendimit.

II – LLOJET, KRITERËT DHE KUSHTET PËR SHKOLLIMIN FALAS (BURSË)

Neni 2

Kolegji ndanë bursa për student për studime të nivelit Bachelor (BA) dhe të nivelit Master (MA). Kolegji Dardania ndanë:

- Bursa të plota;
- Mbështetje financiare.

Neni 3

Kolegji Dardania ndanë:

- Bursa për student shembullor; dhe
- Mbështetje financiare për:
 - familje të viktime –luftës dhe veteran;
 - për familje me ndihmë sociale;
 - për studentët e të njëjtës familje.

Neni 4

Kriteret për bursë për student shembullor

Bursën për student shembullor e fitojnë kandidatët të cilët kanë kryer me sukses shembullor vitin e I-rë dhe e kanë regjistruar në afat vitin e II-të për studentët e nivelit BA dhe MA. Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret në vijim:

4.1. Kriteret akademike

- Nota mesatare 9.5;
- Të ketë regjistruar semestrin e 3-të;
- Të ketë referencën e një mësimdhënësi të vitit paraprakë.

4.2. Kriteret teknike

- Të mos kenë vit të përsëritur;
- Të jenë të rregullt në ligjërata, ushtrime dhe aktivitete studimore;
- Të jenë të rregullt në aktivitetet e Kolegjit;
- Të jenë aktivë në strukturat menaxheriale të studentëve;
- Të marrin pjesë në aktivitetet e organizuara nga studentët;
- Të kenë sjellje shembullore me kolegë studentë, mësimdhënës, staf administrativ dhe komunitet;

Neni 5

Kolegji Dardania shpall konkurs për kriteret, afatin, dhe mënyrën e aplikimit, më së largu deri me 10 tetor të çdo viti akademik. Konkursi publikohet në:

- Web-site të Kolegjit;
- DMIS;
- Në tabelën e shpalljeve të Kolegjit.

Në tekstin e konkursit respektohet afati prej së paku 7 ditësh, vendi dhe mënyra e aplikimit, afati i shqyrtimit të dokumentacionit, mënyra e përzgjedhjes, data e publikimit të rezultateve dhe afati i procedurës ankimuese.

Neni 6

Studentët të cilët përzgjidhen do të fitojnë bursë një vjeçare.

Neni 7

Kriteret për mbështetje financiare.

Mbështetje financiare e fitojnë studentët e nivelit Bachelor (BA) dhe nivel Master (MA) të cilët i përkasin këtyre kategorive:

- familje të viktime – luftës dhe veteran;
- për familje me ndihmë sociale;
- për studentët e të njëjtës familje.

Me qëllim të mbështetjes për studentët të nivelit BA të cilët kanë treguar rezultate të shkëlqyeshëm në shkollimin e mesëm përkatësisht në provim të matures dhe të cilët nuk kanë mundësi financiare për mbullimin e taksës të studimeve, Kolegji Dardania ofron mbështetje financiare.

Numri i shfrytëzuesve për kategoritë e mësipërme caktohet me vendim të vecant nga Këshilli drejtues i Kolegjit në fillim të vitit akademik.

Për fitimin e mbështetjes financiare të kategorive të mësipërme (duke përfshirë nivelin BA dhe MA), Kolegji hap konkurs, në të cilin konkurs përcaktohen afati prej së paku 7 ditësh, vendi dhe

mënyra e aplikimit, afati i shqyrtimit të dokumentacionit, mënyra e përzgjedhjes, data e publikimit të rezultateve dhe afati i procedurës ankimore.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim për shfrytëzues të mbështetjes financiare janë:

- dëftesat përkatëse nga shkollimi i mesëm i lartë;
- certifikata e provimit të matures shtetërore;
- vërtetimi nga QPS;
- vërtetimi nga Shoqata e veteranëve dhe viktimave të luftës;
- certifikata e notave për suksesin e treguar në studime.

Nëse numri i kandidatëve të paraqitur për shfrytëzues të mbështetjes financiare e kalon numrin e caktuar me vendim nga Këshilli Drejtues i Kolegjit, atëherë organizohet intervistë vlerësuese me aplikuesit.

Neni 8

Nëse përfitues i mbështetjes financiare nuk i përmbush kriteret e kërkuara, sic janë: suksesi gjatë vitit të pare akademik, duke mos i përfillur kushtet e parapara dhe sjellet në kundërshtim me kodin e etikës së Kolegjit Dardania, studenti/ja e humbë të drejtën e shfrytëzimit të mbështetjen financiare.

III – PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES

Neni 9

Këshilli Drejtues i Kolegjit Dardania me vendim të vecantë e formon komisionin në përbërje të pesë anëtarëve prej të cilëve njëri është përfaqësues i studentëve.

- Përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët do të jenë përfitues të bursave përkatësisht të mbështetjes financiare bëhet nga komisioni i vecantë i ngritur nga Këshilli drejtues;
- Komisioni në përbërje të plotë i shqyrton aplikacionet detajisht dhe e përpilon rang-listën e përfituesve të mundshëm;
- Në rastet kur numri i aplikuesve në rang-listë është më i lartë se numri i përfituesve të mundshëm për bursa apo për përfitues të mbështetjes financiare, atëherë komisioni e publikon datën dhe kohën e intervistimit të kandidatëve sipas rang-listës;
- Intervistimi i kandidatëve realizohet me gojë para panelistëve intervistues, të cilët individualisht e bëjnë vlerësimin me pikë;
- Komisioni e përpilon rang-listën definitive dhe kandidatët më të sukseshmëm i rekomandon këshilli drejtues për aprovim;
- Vendimi definitiv për përfitues të bursës ose mbështetjes financiare e merr Këshilli Drejtues i Kolegjit Dardania.
- Lista e përfituesve të bursave ose të mbështetjes financiare publikohet në webfaqen e Kolegjit Dardania, DMIS dhe në tabelën e shpalljeve në foaje.

IV. PROCEDURA ANKIMORE

Neni 10

Aplikantët e pakënaqur e gëzojnë të drejtën e ankesës ndaj vendimit. Ushtrimi i ankesës i ushtrohet Këshillit Drejtues të Kolegjit Dardania.

- Aplikanti i pakënaqur me vendimin e Këshillit Drejtues ushtron ankesë me shkrim për rishqyrtim të vendimit brenda 48 orësh nga publikimi i vendimit;
- Aplikanti me shkrim i paraqet arsyet e ankesës;
- Këshilli Drejtues e shqyrton ankesën e aplikantit në afatin brenda 48 orësh;
- Këshilli Drejtues e publikon listen e rishikuar e cila konsiderohet përfundimtare;
- Aplikantët nuk kanë të drejtë ankese në vendimin përfundimtar.

V. OBLIGIMET DHE PËRGJEGJËSITË E BURSISTIT DHE TË PËRFITUESIT TË MBËSHTEJES FINANCIARE

Neni 11

Përfituesit e bursës nënshkruajnë kontratë me zyrtarin e Kolegjit Dardania me të cilin përcaktohen të drejta dhe obligimet e palëve.

Neni 12

Studentët burësistë dhe përfituesit e mbështetjes finaciare duhet ti përmbushin këto obligime:

- Të vijojnë rregullisht ligjeratat, ushtrimet, angazhimet seminarike, konsultimet dhe aktivitete tjera mësimore;
- Të mos kenë vitë të përsëritur;
- Të jenë aktivë në strukturat menaxheriale të studentëve;
- Të marrin pjesë në aktivitetet e organizuara nga studentët;
- Të kenë sjellje shembullore me kolegë studentë, mësimdhënës, staf administrativ dhe komunitet;
- Të respektojnë kodin etik të Kolegjit Dardania.

Neni 13

Studentët burësistë dhe përfituesit e mbështetjes finaciare e humbin të drejtën e bursës ose të mbështetjes finaciare në rastet kur nuk e respektojnë kriteret e nenit 12 si dhe në rastet kur veprojnë në kundërshtim me aktet normative, kur pa ndonjë arsye i lëshon afatet e provimeve ose kur i ndërpret studimet.

Neni 14

Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Kolegjit Dardania. Më hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje çfuqizohen rregullorja paraprake.

Kryetari i Këshillit drejtues
Prof. Dr. Haki Demolli

